REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar më: Primljeno: | 24.12.2024 | |
|---|---|---|
| Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 01-052/01 | 62864 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**ZYRA E KRYETARIT**

| | |
|---|---|
| **Datë:** | 24.12.2024 |
| **Referencë:** | |
| **Për:** | Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit<br>Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit |
| **Kopje:** | Diamant Bytyqi– Nënkryetar i Komunës<br>Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës |
| **Nga:** | Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsutlimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit. |
| **Lënda:** | Raport nga procesi i konsultimit publik i draft- Rregullores për Transparencë në Komunën e Lipjanit |

**Hyrje**

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit Komisioni për hartimin e Rregullores për Transparencë në Komunën e Lipjanit dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsutlimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

**Projekt Rregulloren për Transparencë në Komunën e Lipjanit**

Ku është publikuar edhe njoftimi me bashkëlidhjen e konlsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës si dhe në platformen e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës.

**Shih linqet:**

https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/11/Vendim-per-konsultimin-e-publikut-Draft-RRegullorja-per-Transparence-1.pdf

https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42706

**Ecuria e Procesit**

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike kanë publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 03.12.2024 për mbajtjen e konsultimit-debatit publik draft Rregulloren për Transparencë në Komunën e Lipjanit.

**në linkun:**

https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/12/Njoftim-per-debat-publik-per-Projekt-Rregulloren-per-Transparence.pdf

https://www.facebook.com/photo.php?fbid=979587427528939&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 11.12.2024 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora 10:00

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

https://kk.rks-gov.net/lipjan/?newscpt=debati-publik-per-transparencen-ne-komunen-e-lipjanit

Fillimisht është prezantuar komisioni për hartimin e Draft- Rregullores për Transparencë në Komunën e Lipjanit në përbërje:

1. Bukurie Zejnullahu-Jashari, kryesuese
2. Valdete Muji, Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Qendresa Jashinca –Dërmaku, Sektori për Marrëdhënie me Publikun, anëtare
4. Burim Gashi, Drejtorati për Adminitratë, anëtar dhe
5. Pranvera Krasniqi, Drjeotrati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare

Përfaqësues nga Komisioni për hartimin e kësaj Draft- Rregullore kanë hapur takimin dhe para të pranishmëve kanë prezantuar rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit si dhe mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast përfaqësues të komisionit kanë potencuar se ky takim është organizuar me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.



Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast përfaqësues të komisionit kanë potencuar se ky takim është organizuar me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.

Nga ana tjetër të pranishmit paten rastin të inkuadrohen ne debat dhe të japin kontributin e tyre për të këtë draft që të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe në përputhje me normat më të larta të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.

Bekim Krasniqi, përfaqësues i Youth Association for Human Rights ka paraqitur disa sugjerime të cilat po i paraqesim më poshtë :

- KAPITULLI II - TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS:

Të shtohet neni 10

Neni 10: "Krijimi i Kushteve për Pjesëmarrjen e Publikut dhe Organizatat e Shoqërisë Civile":
Në këtë nen, është propozuar të krijohen kushte të përshtatshme dhe të aksesueshme për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në takimet e Kuvendit të Komunës, duke siguruar mundësi të barabarta dhe pa diskriminim. Kjo përfshin ofrimin e informacionit për datat, oraret dhe agjendën përpara seancave, si dhe mundësinë për të kontribuar në çdo fazë të vendimmarrjes.

**Gjatë fazës së diskutimit publik për rregulloren e transparencës në Komunën e Lipjanit, Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuara nga palët e interesuara, përfshirë këtu rekomandimet e pranuara nga organizata joqeveritare "Youth Association for Human Rights".**

> ➢ Komisioni ka potencuar se draft - rregullorja ekzistuese i adreson në mënyrë të duhur të gjitha aspektet e transparencës për Kuvendin dhe ekzekutivin e Komunës.

- KAPITULLI III - TRANSPARENCA E EKZEKUTIVIT:

Neni 10 të bëhet neni 11

Neni 10 - "Transparenca e Ekzekutivit":
Shtimi i pikes 5, ku propozohet që Komuna të sigurojë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë punën e ekzekutivit në mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve. Ky ndryshim do të mundësojë që organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë në diskutime dhe të ofrojnë rekomandime për politikat dhe aktivitetet e drejtorive, duke siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri të shtuar.

> ➢ Pas analizës së detajuar, komisioni ka arritur në përfundimin se këto rekomandime janë të përfshira në thelb brenda dispozitave ekzistuese të rregullores. Si rezultat, përfshirja e këtij ndryshimi është mbuluar nga kuadri ekzistues ligjor.

- KAPITULLI IV - PUBLIKIMI I AKTEVE, DOKUMENTEVE ZYRTARE DHE FINANCIARE DHE AKTEVE TË TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT:

Neni 11 - "Publikimi i Akteve të Komunës":
Pika 3 të ndryshohet, duke propozuar që Komuna të publikojë aktet, raportet javore dhe mujore, si dhe dokumentet tjera të nxjerra nga drejtoritë komunale në uebfaqen zyrtare të Komunës. Ky ndryshim synon të sigurojë informacion të detajuar për aktivitetet, shpenzimet dhe progresin e projekteve, duke rritur transparencën për qytetarët dhe palët e interesua

- Draft - Rregullorja aktuale përcakton publikimin e akteve dhe dokumenteve në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe vetë përmendja e këtyre dokumenteve nënkupton përfshirjen e raporteve javore dhe mujore.

Nga ana tjetër të pranishmit paten rastin të inkuadrohen ne debat dhe të japin kontributin e tyre për të kompletuar këtë dokument të rëndësishëm.

**Komentet nga debati konsultativ lidhur Projekt Rregulloren për Transparencë në Komunën e Lipjanit**

| Temat e Konsultimit | Komentet | **Kush ka komentuar** | Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara | Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|---|---|
| Projekt Rregulloren për Transparencë në Komunën e Lipjanit | Të shtohet neni 10 Neni 10: "Krijimi i Kushteve për Pjesëmarrjen e Publikut dhe Organizatat e Shoqërisë Civile": Në këtë nen, është propozuar të krijohen kushte të përshtatshme dhe të aksesueshme për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në | **Bekim Krasniqi YAHR** | Komisioni ka potencuar se draft - rregullorja ekzistuese i adreson në mënyrë të duhur të gjitha aspektet e transparencës për Kuvendin dhe | Komenti u pranua pjesërisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | takimet e Kuvendit të Komunës, duke siguruar mundësi të barabarta dhe pa diskriminim. Kjo përfshin ofrimin e informacionit për datat, oraret dhe agjendën përpara seancave, si dhe mundësinë për të kontribuar në çdo fazë të vendimmarrjes. | | ekzekutivin e Komunës. | |
| Projekt Rregulloren për Transparencë në Komunën e Lipjanit | Neni 10 të bëhet neni 11<br>Neni 10 - "Transparenca e Ekzekutivit":<br>Shtimi i pikes 5, ku propozohet që Komuna të sigurojë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë punën e ekzekutivit në mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve. Ky ndryshim do të mundësojë që organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë në diskutime dhe të ofrojnë rekomandime për politikat dhe aktivitetet e drejtorive, duke siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri të shtuar. | | Pas analizës së detajuar, komisioni ka arritur në përfundimin se këto rekomandime janë të përfshira në thelb brenda dispozitave ekzistuese të rregullores.<br>Si rezultat, përfshirja e këtij ndryshimi është mbuluar nga kuadri ekzistues ligjor. | Komenti u pranua plotësisht |
| Projekt Rregulloren për Transparencë | Neni 11 - "Publikimi i Akteve të Komunës":<br>Pika 3 të ndryshohet, duke propozuar që | **Bekim Krasniqi YAHR** | Draft - Rregullorja aktuale përcakton publikimin e akteve dhe dokumenteve në | Komenti u pranua plotësisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në Komunën e Lipjanit | Komuna të publikojë aktet, raportet javore dhe mujore, si dhe dokumentet tjera të nxjerra nga drejtoritë komunale në uebfaqen zyrtare të Komunës. Ky ndryshim synon të sigurojë informacion të detajuar për aktivitetet, shpenzimet dhe progresin e projekteve, duke rritur transparencën për qytetarët dhe palët e interesua | | uebfaqen zyrtare të Komunës dhe vetë përmendja e këtyre dokumenteve nënkupton përfshirjen e raporteve javore dhe mujore. | |

**Gjatë fazës së diskutimit publik për rregulloren e transparencës në Komunën e Lipjanit, Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuara nga palët e interesuara, përfshirë këtu rekomandimet e pranuara nga organizata joqeveritare "Youth Association for Human Rights".**

**Takimi mbaroi në ora 11:15**

| Metodat e Konsultimit | Datat/kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve |
|---|---|---|
| 15-30 ditë pranohen komentet | | 16 |
| 15-30 ditë | | |

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **16** pjesëmarrës, prej tyre femra **10** dhe **6** meshkuj.

**Bukurie Zejnullahu-Jashari**
**Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**Datë:** 11.12.2024

**Vendi:** Salla e Kuvendit

**Lista e pjesëmarrësve: Rregullorja për transparencën në Komunën e Lipjanit**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Bekim | Krasniqi - YAAK | |
| 2 | Blerton | Sadiku | |
| 3 | Shkelzen | Hoti | |
| 4 | Armend | Kazhani | A. K |
| 5 | HAZBI | ADEMI | |
| 6 | Qëndresa | Jashanica Dërmaku | |
| 7 | Valdete | Muji | |
| 8 | Ferdion | Shala | |
| 9 | Bukure Gjul | [illegible] | |
| 10 | Besa | Rexhepi | |
| 11 | Leonita | Bublica | |
| 12 | LOURATA FAZLIJA | | |
| 13 | Xhevahire Jegiu | | |
| 14 | Medina Bublica | | |
| 15 | Lumnije Gjupi | | |
| 16 | VLORA KRASNIQI | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |